

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/dokumenti-i-be-se-rusia-dergoi-femije-ukrainas-te-rrembyer-ne-nje-kamp-ne-k-i584279
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 11:43:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 12:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b96302b96fab44db81b49426de551b193e61538ce1fdce8d52c70a1b64e9722e
TEKSTI	9c7253c900277d41563c080d88b2d635594f05124a52de1a8db9db0564b6f1d0
PAMJA	f79e78ffa535b95c17ae833e10884a20edb41d1e96deff7cf290db5d814958d5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	77385a3945ec51272865060b8b82b683eef28a58fdb217aae3b7975558030867
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a09a13f159440b4b4b78274a5efc8a257b0de4b0ce6a8edbd97a53218837c6
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmRLvSTN7qJX7YU63hBUp5SdxP2zbWfMaJ3xxh6AhHW7vy



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/77385a3945ec51272865060b8b82b683eef28a58fdb217aae3b7975558030867>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Njerezit qe pastrojne Tiranen/ Flasin ata qe punojne kur te tjeret flene: Nuk na lodh puna, por sjellja e qytetareve "Dekolonizim" apo censure? Qyteti rusishtloles i Odesses](#)
fundit

Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut



6 Shtator 2026, 14:15 Bota TEMA



Rusia ka dërguar fëmijë të rrëmbyer ukrainas në një kamp veror në Korenë e Veriut, sipas një dokumenti të Bashkimit Evropian të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë, ku përshkruhet rundi i ri i planifikuar i sanksioneve.

Dokumenti liston personat dhe entitetet që do të përfshihen në sanksionet e reja të BE-së ndaj Rusisë, të cilat pritet të miratohen javën e ardhshme.

Personat e propozuar për sanksionim janë kryesisht zyrtarë të lartë në territoret e pushtuara nga Rusia në Krime dhe Donbas, por ndoshta emri më i spikatur në listë është Kampi Ndërkombëtar i Fëmijëve Songdovon, i cili drejtohet nga autoritetet e Koresë së Veriut.

Në dokument thuhet se ky kamp "merr pjesë në programe të organizuara që përfshijnë transferimin e fëmijëve ukrainas nga territoret e pushtuara përkohësisht të Ukrainës në Korenë e Veriut".

Transferimet koordinohen nga zyrtarë rusë dhe, ndonëse supozohet se bëhet fjalë për "shkëmbim kulturor", në dokument thuhet se ai "shërben për një funksion më të gjerë propagandistik: fëmijët ukrainas ekspozohen ndaj narrativëve të përzgjedhur prorusë".

Me fjalë të tjera, shtohet në dokument, kampi "është i përfshirë drejtpërdrejt në transferimin e paligjshëm, indoktrinimin ideologjik dhe militarizimin e fëmijëve ukrainas në bashkëpunim me Federatën Ruse".

Kampi gjendet në bregun lindor të Koresë së Veriut, në Detin e Japonisë, rreth 95 kilometra nga kufiri me Korenë e Jugut.

Uri Tours, një kompani në Korenë e Veriut që promovon kampin, thotë se ai është më i madhi në vend dhe është hapur në vitin 1960 për "promovimin e miqësisë ndërkombëtare".

Kampi ishte sanksionuar nga Mbretëria e Bashkuar në maj, për "ofrimin e mbështetjes për programin e Qeverisë së Rusisë për dëbimin me forcë dhe riedukimin e fëmijëve ukrainas".

Koris e Veriut u përballi duke tërhequr ambasadorin e saj nga Londra dhe duke ulur nivelin e raportave diplomatike.

Koreja e Verit e përgjigj dritë kompjuterike të saj nga Londra dhe dritë dritë të saj nga raportet e diplomacisë.

Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN) ka lëshuar një fletarrestim për presidentin rus, Vladimir Putin, për "dëbimin e paligjshëm... të fëmijëve ukrainas".

Përfshirja e Koresë së Veriut në fushatën e Rusisë për rrëmbimin e fëmijëve duket se e rrit më shumë rolin e saj në luftë.

Koreja e Veriut dërgoi rreth 12.000 trupa për të luftuar përkrah forcave ruse në vitin 2024, pas inkursionit të Ukrainës në rajonin e Kurskut. Inteligjenca e Koresë së Jugut ka raportuar se rreth 2.000 trupa të Phenianit janë vrarë në luftime.

Së fundi, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, deklaroi se në Rusi do të dërgoheshin më shumë trupa të Koresë së Veriut, të cilat mund të përdoren për operimin e raketave balistike, të prodhuara nga Pheniani, në sulmet ndaj Ukrainës.

Entitetet e tjera të renditura në listën e sanksioneve të BE-së janë të ashtuquajturat "kampe verore" në Rusi ose në rajonet e pushtuara të Ukrainës.

Sipas bllokut evropian, fëmijët e dërguar atje ekspozohen ndaj programeve që nxisin "besnikërinë ndaj Rusisë, identitetin kombëtar rus, përvetësimin e vlerave kombëtare ruse, tema të historisë ushtarake dhe pjesëmarrjen në aktivitete të lidhura me organizatat ushtarake-patriotike".

Në dokument thuhet po ashtu se këto lloj dëbimesh "përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare dhe shkelje të të drejtave themelore të fëmijës, që kanë për synim fshirjen e identitetit ukrainas dhe cenimin e ruajtjes së identitetit të brezave të ardhshëm".

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë

13:35 Bota

Tragjedi në Kepin e Gjelbër, autobusi me studentë bie nga 30 metra! Të paktën 21 viktima

13:15 Bota

Droni rus godet selinë qendrore të SBU-së në Kiev, Zelensky: Do të përgjigjemi!

12:55 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.